



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.37/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike lidhur me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, e duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.237/2025, të datës 30.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 05.02.2025, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.237/2025, të datës 30.01.2025.

### A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.237/2025, të datës 30.01.2025, është vendosur: “I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.237/2025 e datës 29.01.2025. II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10.000 (Dhjetëmijë) euro. III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi”.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke mos i specifikuar shkaqet e ankesës, ndërsa si pretendim kryesor ankimor i saj është se vendimi i PZAP-së është marrë si rezultat i konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit material, pasi që nuk është arritur të argumentohet përgjegjësia subjektive e subjektit politik PKD, respektivisht nuk është vërtetuar me asnjë provë ndërlidhja e veprimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë ngjarje me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, ndonëse veprimet e këtyre grupeve i kanë vlerësuar

si të ndaluara, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin A.nr.237/2025, të datës 30.01.2025, ashtu që të refuzoj si të pabazuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, pasi që nuk është arritur të vërtetohet përgjegjësia subjektive e Partisë Demokratike të Kosovës.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.237/2025, i datës 30.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 27.01.2025 në tubimin e planifikuar nga LVV në Skenderaj, simpatizantët dhe aktivistë të PDK-së, fillimisht brohoritën, fishkëllyen dhe hodhën fishekzjarrë në drejtim të organizuesve, qytetarëve dhe kandidatëve për deputet të LVV-së me qëllim që ta pengojnë dhe ta shtyjnë tubimin në kohën e planifikuar nga LVV në Skenderaj. Parashtruesi i ankesës thekson se në fillim përkrahësit, simpatizantët dhe aktivistët e PDK-së brohoritën në vazhdimësi "Albin rrenci", "Hashim Thaçi....." dhe gjithashtu hodhën mjete piroteknike në drejtim të qytetarëve pjesëmarrës në tubimin e LVV-së, të organizuar në Shtëpinë e Kulturës "Hasan Prishtina" në Skenderaj. Sipas parashtruesit të ankesës për shkak të këtyre veprimeve dhe pengesave të vazhdueshme, fyerjeve dhe po ashtu ndërprerjes së rrymës elektrike për një kohë të caktuar tubimi i LVV në Skenderaj u pengua dhe kësaj tubimi i tillë u shty për afërsisht për 30 minuta. Me këtë parashtruesi i ankesës thekson se aktivistët dhe mbështetësit e PDK-së me brohoritje dhe fishekzjarrë dhe fishkëllima bërtisnin "PDK" "Poshtë Udbasha-at" "Zdravo", duke pretenduar se me këto veprime është shkelur neni 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4; 1.7 në lidhje me nenin 1.11 të LPZ-së. Si provë për shkeljen e pretenduar kanë bashkëngjitur një CD dhe linçet për shkeljen e pretenduar, dhe reagimet e OJQ-ve.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 30.01.2025, Subjekti Politik PDK ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me pretendim se pala ankuese nuk ka arritur që ta argumentoj përgjegjësinë subjektive ndaj subjektit politik PDK dhe se ankuesi me asnjë provë nuk ka arritur që të bëjë ndërlidhjen e veprimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë ngjarje me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo të njëjtit janë mjaftuar vetëm me pretendimin se të njëjtit janë simpatizant dhe aktivist të PDK-së. Po ashtu me përgjigje në ankesë theksohet se PDK dega në Skenderaj me datën 27.01.2025 ka anuluar të gjitha aktivitetet politike për shkak të një aksidenti të ndodhur në fshatin Qubrel të Skenderajt dhe mbi këtë bazë e kanë vlerësuar të paqëndrueshëm pretendimin se aktivistët dhe simpatizantët e PDK-së janë të përfshirë në ngjarjen e lartcekur dhe për këtë arsye janë deklaruar edhe zyrtarët e lartë të PDK-së, të cilët janë distancuar nga veprimet e tilla. Me përgjigje në ankesë po ashtu është thekuar se ekzistojnë dyshimet se një

incident i tillë ka mundur të jetë jetë inskenuar nga vetë simpatizantët e subjektit politik LVV me qëllim që të dëmtohet subjekti politik PDK. Andaj, rrjedhimisht i propozoi PZAP-së që ankesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj subjektit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ta refuzoj si të pabazuar.

PZAP, pas shikimit të CD të ofruar si provë materiale, ka vërejtur se në tubimin e subjektit politik LVV të mbajtur në Skenderaj në Shtëpinë e Kulturës "Hasan Prishtina", simpatizantët dhe aktivistë të PDK-së me qëllim që ta pengojnë zhvillimin e fushatës zgjedhore të subjektit politikë ankues LVV, kanë penguar mbajtjen e tubimit publik ku me atë rast, kanë brohoritur dhe fishkëlluar dhe më pastaj kanë hedhur mjete piroteknike dhe fishekzjarrë në drejtim të organizuesve, qytetarëve dhe kandidatëve për deputet të LVV-së. Gjatë kësaj kohe të njëjtit në vazhdimësi kanë brohoritur "Hashim Thaçi....." "PDK....PDK", "Posht Udbasha-at", "Zdravo", Albin rrenci".

Paneli vlerëson se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4; 1.7 dhe 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsë si në vijim: çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë, kërcënim i ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatet e tyre, përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*. Ndërsa neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) euro.

Sipas Panelit nga përmbajtja e video incizimeve shihet se në veprimet e simpatizantëve të subjektit politik PDK është përdorë gjuhë fyese, nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve, si dhe kanë penguar mbajtjen e tubimit në kuadër të fushatës zgjedhore, duke hedhur mjete piroteknike dhe fishekzjarrë e cila ka ndikuar në shtyrjen e mbajtjes së tubimit dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosferë destabiliteti. Paneli ka vlerësuar se përdorimi i gjuhës së tillë, si dhe veprimet të cilat kanë për qëllim çrregullimin e tubimeve të subjekteve tjera politike mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend, duke theksuar se kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë. Andaj, Paneli gjeti se veprimet e tilla të subjektit politik PDK janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike

dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, 1.7 dhe 1.11 të LZP-së.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes së vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik PDK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje i njëjti e mohon shkeljen e bërë, andaj pretendimet e parashtruara në përgjigje në ankesë për Panelin janë të pabazuara. Si rezultat i kësaj këto veprime të tilla vlerësohen se janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, 1.7, 1.11, si dhe nenit 118 paragraf 1, për çka edhe me të drejtë subjektit politik në fjalë i është shqiptuar gjoja në pajtim me dispozitën e nenit 120 paragraf 1, nën paragrafi 1.3 të LZP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, e paraparë në nenin 34, nënparagrafi 1.4, 1.7 dhe 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24, pika 9.1 të Rregullores 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe lartësinë e gjobës së shqiptuar, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, ashtu si thekson parashtruesi i ankesës, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese, siç është CD e ofruar si provë materiale dhe linqet që vërtetojnë faktin se në tubimin e subjektit politik LVV të mbajtur në Skenderaj në Shtëpinë e Kulturës "Hasan Prishtina", më datë 27.01.2025, simpatizantë dhe aktivistë të PDK-së, me qëllim që ta pengojnë zhvillimin e fushatës zgjedhore të subjektit politikë ankues LVV, respektivisht mbajtjen e tubimit publik të këtij subjekti, kanë brohoritur dhe fishkëlluar dhe më pastaj kanë hedhur mjete

piroteknike dhe fishekzjarrë në drejtim të organizuesve, qytetarëve dhe kandidatëve për deputet të LVV-së. Në lidhje me këtë, nga simpatizantët e subjektit politik PDK, rezulton të jenë përdorur fjalët: "Hashim Thaçi....." "PDK....PDK", "Posht Udbasha-at", "Zdravo", "Albin rrenci", prej nga rrjedh se këto veprime të simpatizantëve të subjektit politik PDK, kanë pasur qëllim etiketimin e subjektit politik LVV dhe promovimin e subjektit politik PDK, e veçanërisht etiketimin dhe pengimin në mbajtjen e tubimit politik të LVV-së, duke hedhur mjete të rrezikshme, si dhe duke krijuar atmosferë tensioni dhe nxitje të urrejtjes dhe të përçarjes ndaj subjektit politik në fjalë.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP në vendimin e atakuar se pjesmarrësit, respektivisht simpatizantët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe promovimit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë nxitur urrejtje ndaj subjektit politik LVV, në atë mënyrë që në tubimin e organizuar nga ky subjekt, është përdorë gjuhë fyese, nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve, si dhe kanë penguar mbajtjen e tubimit në kuadër të fushatës zgjedhore, duke hedhur mjete piroteknike dhe fishekzjarrë e cila ka ndikuar në shtyrjen e mbajtjes së tubimit. Ndërsa kjo me të drejtë është konstatuar nga PZAP si shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se me këto veprime është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti neni 34 paragraf 1, pika 1.4, 1.7 dhe 1.11, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet: *"1.4 çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë; 1.7 kërcënim i ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre; 1.11 Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".*

Pretendimi ankimor se subjekti politik PDK, nuk ka përgjegjësi për veprimet e pjesmarrësve në tubimin e organizuar nga subjekti politik LVV, pasi që nuk është arritur të argumentohet përgjegjësia subjektive e subjektit politik PKD, respektivisht nuk është vërtetuar ndërlidhja e veprimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë ngjarje me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, duke u distancuar nga veprimet e tilla, me pretendim se një incident i tillë ka mundur të jetë jetë inskenuar nga vetë simpatizantët e subjektit politik LVV me qëllim që të dëmtohet subjekti politik PDK, është pretendim i pabazuar. Kjo për faktin se veprimet e simpatizantëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të cilat janë provuar përmes provave të administruara e të cekura më lartë, të cilat i ka vlerësuar edhe kjo gjykatë, kanë ndikuar në çrregullimin e tubimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke kërcënuar subjektin politik LVV, duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti, me brohorimat "Hashim Thaçi....." "PDK....PDK", "Posht Udbasha-at", "Zdravo", "Albin rrenci", e po ashtu duke hedhur mjete piroteknike dhe fishekzjarrë në drejtim të organizuesve, qytetarëve dhe kandidatëve për deputet të LVV-së. Në rastin konkret, me të drejtë është konstatuar nga PZAP-

i se simpatizantët e subjektit politik PDK, me qëllim të pengojnë tubimin e subjektit politik LVV, të nxisin ndjenja të urrejtjes dhe krijojnë atmosferë tensioni dhe përçarjeje, kanë krijuar një situatë tensionuse me hedhjen edhe të mjeteve piroteknike, krejt këto me qëllim të pengimit të mbajtjes së tubimit të subjektit të lartcekur. Si rezultat i kësaj këto veprime të tilla vlerësohen se janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 pika 1.4, 1.7 dhe 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), për çka edhe me të drejtë subjektit politik në fjalë i është shqiptuar gjoja në pajtim me dispozitën e nenit 120 paragraf 1, nënparagrafi 1.3 të LZP-së.

Gjykatës Supreme i rezulton se veprimet e tilla të simpatizantëve dhe përkrahësve të subjektit Politik PDK, në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së, lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marrë parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoja e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 10,000.00 €, është e drejtë dhe e ligjshme, me të cilën vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i saj, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes. Në anën tjetër, rezulton se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës, ka marrë për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë këtu shkallën dhe peshën e shkeljes dhe natyrën e shkeljes.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.37/2025, datë 05.02.2025

Kryetari i kolegjit,  
Lumni Sallauka